



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Glllogocit
Drejtoria e Inspektionit
Glllogoc, me: 15.11.2017



Për: Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Drenasit, **z. Tafil Halili**

Nga: Drejtoria e Inspektionit - Aurora Berisha, Drejtoreshë e Drejtorisë

CC: Zyra e Kryetarit – Ramiz Lladrovci

Data: 16.11.2017

R A P O R T I

I INSPEKTIMIT NË INSTITUCIONET ARSIMORE NË KOMUNËN E DRENASIT SHTATOR-TETOR-NËNTOR 2017

Në bazë të detyrës zyrtare që ka Inspektori Sanitar Komunal dhe me qëllim të përmirësimit të kushteve teknike-higjieno-sanitare në hapësirat e shkollave, kemi bërë kontrollë të përgjithëshme në të gjitha institucionet arsimore në Komunen e Drenasit.

Gjatë inspektimit në shkolla janë kontrolluar kushtet higjenike dhe teknike në hapësirat e klasëve ku zhvillohet mësimi, koridoret dhe në veçanti nyjet sanitare.

Në vazhdim kemi paraqitur një pasqyrë të kushteve teknike dhe higjenike të të gjitha shkollave dhe qerdheve publike në Komunën e Drenasit të inspektuara gjatë muajit shtator, tetor dhe nëntor të vitit 2017 :

1. SH.F.M.U “Rasim Kiqina”, Drenas

Gjatë inspektimit tonë me datë 17.10.2017 është konstatuar (procesverbali 002287) se në hapësirën e kësaj shkolle pas vërejtjeve të dhëna me procesverbalin e herës së kaluar ka përmirësime, por nuk ka riparim të nyjeve sanitare, dyshemes së koridoreve dhe klasëve, mureve, dyerve dhe dritareve, për një kohë të gjatë. Kjo shkollë ka 3 punëtor teknik të cilët janë të pamjaftueshëm për mirëmbajtjen e shkollës.

2.SH.F.M.U “ Bajram Curri”, Nekoc

Gjatë inspektimit të bërë me datën 14.09.2017 në këtë shkollë është konstatuar (procesverbal 002099) se është një gjendje jo e mirë higjienike, në veçanti në nyje sanitare ku ka rrjedhje të ujit në dysHEME dhe kundërmon erë e keqe, andaj, është kërkuar që të përmirësohen kushtet dhe të përsëritet në intervale më të shpeshta kohore pastrimi brenda hapësirës së shkollës.

3. SH.M.P”Fehmi Lladrovci”, POKLEK I RI

Gjatë inspektimit në këtë shkollë me datë 07.09.2017 kemi konstatuar një gjendje të mirë higjienike në ambientin brenda shkollës dhe nyjeve sanitare. Vërejtja jonë ishte për sallën e sportit të kësaj shkolle, ku nyjet sanitare, zhveshtorja e femrave që funksionon brenda kësaj salle nuk mirëmbahet, andaj nuk i plotëson kushtet minimale higjieniko-sanitare.

4. SH.F.M.U “Luigj Gurakuqi”, SANKOC

Gjatë inspektimit të bërë me datën 03.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002128) se në këtë shkollë kushtet higjieniko sanitare janë në nivelin mesatar. Nyjet sanitare duhet të pastrohen dhe mirëmbahen rregullisht.

5. SH.F.M.U “Xheladin Gashi-Plaku”, KOMORAN

Gjatë inspektimit të bërë me datën 10.10.2017 në këtë shkollë është konstatuar (procesverbali 002278) se kushtet higjieniko-sanitare në hapësirat e koridoreve, të klasëve janë të knaqëshme, ndërsa nyjet sanitare nuk janë mirëmbajtur si duhet. Gjithashtu kushtet higjieniko – sanitare në mjetet e punës dhe në hapsirën e kuzhinës që ofron ushqim për nxënësit, e cila ndodhet në hapsirën e shkollës janë të knaqëshme dhe së të gjitha produktet që përdoren për ofrimin e ushqimit dhe pijeve janë me afat të përdorimit.

6. QEAP “Ardhmëria” në Drenas

Gjatë inspektimit të bërë me datën 08.11.2017 në kopshtin “Ardhmëria” në Drenas, është konstatuar (procesverbal 002415) se kushtet higjieniko-sanitare janë në nivelin mesatar, objekti është i vjetër, ka nevojë për përmirësime, sidomos në orëndi të cilat vështësojnë mirëmbajtjen higjienike.

Kuzhina është e mirëmbajtur si duhet dhe produktet me të cilat pregaditet ushqimi për fëmijë janë me afat të përdorimit.

7. QEAP “Ardhmëria” në Komoran

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qender me datë 09.02.2017 është konstatuar (procesverbal 002417) se në hapësirat e klasëve, koridoreve, dhomave të gjumit të fëmijeve, kuzhinës në të cilën përgaditet ushqimi për fëmijë dhe nyjeve sanitare, kushtet higjieniko-sanitare dhe teknike janë në nivelin mesatar.

8. SH.M “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu” në Drenas

Gjatë inspektimit të bërë me datë 23.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002347) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar, pra ka përmirësime në krahasim me inspektimin e kaluar.

9. SH.F.M.U “Halil Bajraktari”, në Drenas II

Gjatë inspektimit të bërë me datën 19.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002290) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare dhe teknike janë në nivelin mesatar.

10. SH.F.M.U “Xhevë Lladrovci”, Gllanasellë

Gjatë inspektimit me datën 13.11.2017 në këtë shkollë është konstatuar (procesverbali 002426) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare i plotësojnë kushtet minimale. Kushtet higjenike dhe teknike janë përmirësuar dukshëm pas vërejtjes së dhënë më parë, është siguruar furnizimi i rregullt me ujë. Por ka mungesë të puntorëve teknik, me vetëm 2 punëtor teknik që janë të pamjaftueshëm për mirëmbajtjen e higjenës brenda kësaj shkolle.

11. SH.F.M.U “Rexhep Gjeli”, në Likoshan

Gjatë inspektimit të bërë më datën 31.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002303) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin e duhur. Nyjet sanitare janë fushore që ndodhen në oborrin e shkollës dhe kushtet higjeniko-sanitare në ato nyje nuk i plotësojnë kushtet minimale për arsye se nuk ka furnizim të rregullt me ujë.

12. SH.F.M.U “Mehmet Gradica”, në Gradicë

Gjatë inspektimit të bërë sipas detyrës zyrtare me datën 31.10.2017, në SH.F.M.U “Mehmet Gradica ” në Gradicë është konstatuar një gjendje jo e mirë higjenike dhe sanitare. Higjena brenda shkollës nuk ka qenë në nivel të duhur edhe pse është bërë renovimi i objektit të shkollës vitin e kaluar, pasi që në këtë shkollë që dy muaj nuk ka fare ujë për pije e as për mirëmbajtje të higjenës në hapësirat e klasëve, koridoreve e sidomos në nyjet sanitare. Punëtorët teknik bartin ujë me dorë nga shtëpitë e fshatit për mirëmbajtjen e higjenës. Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e mungesës së ujit në pusin e ujit më të cilin është furnizuar shkolla më parë.

Drejtori i kësaj shkolle Hajriz Fazliu ka deklaruar se ka njoftuar të gjitha strukturat komunale në Drenas për gjëndjen alarmante në këtë shkollë lidhur me problemin e ujit.

13. SH.F.M.U “Dëshmoret e Fortesës”, në Verboc

Gjatë inspektimit të bërë me datë 04.09.2017 është konstatuar (procesverbal 002090) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar. Pas vërejtjeve të dhëna më parë kushtet tekniko-sanitare janë përmirësuar.

14. SH.F.M.U “Shaban Polluzha”, në Polluzhë

Gjatë inspektimit të bërë me datë 04.09.2017 është konstatuar (procesverbal 002089) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin e duhur. Nyjet sanitare janë të mirëmbajtura dhe muret janë gëlqerosur para fillimit të procesit mësimor.

15. SH.F.M.U “Naim Frashëri”, në Gllobar

Gjatë inspektimit të bërë më datën 11.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002283) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin e duhur.

16. SH.F.M.U “Shaban Polluzha”, Korreticë e Epërme

Gjatë inspektimit të bërë më datën 07.09.2017 është konstatuar (procesverbal 002094) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin e duhur. Nyjet sanitare janë të mirëmbajtura, mirëpo në njërin nyje sanitare të femrave, për shkak një dëmtimi rrjedh uji në dysHEME dhe pllafoni i klasëve është i dëmtuar nga lagështija, e cila depërton nga çatia, andaj pllafonet e këtyre klasëve kanë nevojë për gëlqerosje.

17. SH.F.M.U “Gani Elshani”, në Krajkovë

Gjatë inspektimit të bërë me datë 09.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002110) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin e duhur. Kjo shkollë është renovuar.

18. SH.F.M.U “Jusuf Gervalla”, në Negroc

Gjatë inspektimit të bërë më datën 02.11.2017 është konstatuar (procesverbal 002307) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar. Nyjet sanitare duhen të pastrohen vazhdimisht.

19 . SH.F.M.U “Hasan Prishtina”, në Llapushnik

Gjatë inspektimit të bërë me datën 27.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002299) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare nuk janë në nivelin e duhur. Objekti është i vjetëruar, nyjet sanitare janë të vjetëruara dhe disa prej guaskave janë jashtë funksionit sepse janë të dëmtuara, hapësira e shkollës është e vogël që ka 750m² dhe numër i madh i nxënësve (460 nxënës) në hapësirë të pamjaftueshme krijon vështirësi për mirëmbajtjen e higjenës. Punëtorët teknik bëjnë pastrimin e dysHEMEVE me batanije që nuk lejohet për shkak se liron bakterie.

20 . SH.F.M.U “Fazli Grajqefci”, në Vasilevë

Gjatë inspektimit të bërë më datën 25.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002292) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin e duhur.

21 . SH.F.M.U “Arif Shala”, në Korreticë e Poshtme

Gjatë inspektimit të bërë me datën 04.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002108) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare nuk janë në nivelin e kënaqshëm. Shkolla ka sipërfaqe të madhe dhe ka numër të pamjaftueshëm të punëtorve teknik (2 Puntorë teknik).

22 . SH.F.M.U “7Marsi”, në Kishnarekë

Gjatë inspektimit me datën. 14.09.2017 është konstatuar (procesverbal 002098) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin e duhur. Në nyjet sanitare janë evituar dëmtimet në ujësjellës, muret e klasëve janë gëlqerosur.

23 . SH.F.M.U “Shotë Galica”, në Terdecë

Gjatë inspektimit të bërë më datën 06.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002111) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin e mesatar.

24 . SH.F.M.U “Shotë Galica”, në Abri e Eperme

Gjatë inspektimit të bërë me datë 06.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002111) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar.

25 . SH.F.M.U “Migjeni”, në Baicë

Gjatë inspektimit të bërë më datën 08.09.2017 është konstatuar (procesverbal 002027) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar. Gjatë pushimit vjetor është

bërë gëlqerosja e mureve pjesë-pjesë, sipas nevojës. Shkolla ka sipërfaqe 1400m² , dhe ka vetëm 3 punëtor teknik që janë të pamjaftueshëm për këtë sipërfaqe.

26 . SH.F.M.U “Shotë Galica”, në Abri e Eperme

Gjatë inspektimit të bërë me datën 02.10.2017 është konstatuar(procesverbal 002106) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar. Kushtet teknike në nyjet sanitare janë përmirësuar (guacka dhe qeshme ku kanë qenë të të dëmtuara dhe jashtë funksionit, muret e klasëve janë gëlqerosur sepse kanë qenë të tymosura . Shkolla ka sipërfaqe 300m², 200 nxënës dhe ka 2 punëtor teknik.

27 . SH.F.M.U “Dëshmoret e Qendresës II”, në Tërstenik

Gjatë inspektimit të bërë me datë 15.11.2017 është konstatuar(procesverbal 002431) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar, në nyjet sanitare ka papastërti dhe kundërmon erë e keqe. Kjo shkollë ka sipërfaqe të madhe dhe ka vetëm një punëtor teknik i cili është i pamjaftueshëm për mirëmbajtjen e hapësirës së shkollës.

Drejtori deklaron se në këtë shkollë nuk ka ujë të pijëshëm, nxënësit marrin ujë me vete nga shtëpitë e tyre.

28 . SH.F.M.U “Rilindja”, në Dobroshec

Gjatë inspektimit të bërë me datë 05.09.2017 është konstatuar (procesverbal 002091) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare nuk janë në nivelin e duhur, pasi kushtet teknike nuk janë të mira. Nyjet sanitare janë të dëmtuara tek qeshmet dhe fontanat dhe kjo shkollë ka probleme me ujë sepse gjatë ndërrimit të pasditës nuk ka ujë fare, muret e klasëve janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për gëlqerosje. Shkolla ka sipërfaqe 1200m² , 340 nxënës dhe janë 2 punëtor teknik që janë të pamjaftueshëm për këtë sipërfaqe.

29 . SH.F.M.U “Rilindja”, në Godanc

Gjatë inspektimit të bërë me datën 31.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002301) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare nuk janë në nivelin e duhur edhe pse kushtet teknike janë të mira. Nyjet sanitare janë të pa pastruara, ka gjësende të panevojshme dhe mbeturina. Në këtë shkollë konsumohet duhani. Pas ri-inspektimit të bërë me datën 15.11.2017 në këtë shkollë kushtet higjeno-sanitare janë përmirësuar dukshëm, është bërë pastrimi i hapësirave të klasëve, koridoreve, nyjeve sanitare dhe janë larguar gjë sendet e panevojshme dhe mbeturinat të cilat ishin aty.

30. SH.F.M.U “Dëshmoret e Drenicës”, në Çikatovë eVj etër

Gjatë inspektimit është konstatuar se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar. Nyjet sanitare kanë probleme teknike, fontana dhe disa qeshme kanë qenë jashtë funksionit, muret kanë nevojë për gëlqerosje, mirëpo pas ri-inspektimit të janë evituar këto probleme dhe kushtet teknike-higjeno dhe sanitare qëndrojnë në nivel.

31. SH.F.M.U “ Zenel Hajdini në Tërstenik”

Gjatë inspektimit të bërë me datën 01.11.2017 është konstatuar (procesverbal 002304) se në këtë shkollë kushtet higjeniko sanitare janë në nivelin mesatar. Nyjet sanitare kanë disa dëmtime të qeshmeve , muret janë të dëmtuara nga lagështia , në hapsirën e pllafonit në koridorin e katit të dytë ka hapje prej të cilit rrjedh uji në dysHEME. Shkolla ka sipërfaqe 2400m² ka 271 nxënës dhe ka 4 punëtor teknik.

32. SH.F.M. U“ Azem Bejta në Shtuticë“

Gjatë inspektimit të bërë me datën 01.11.2017 është konstatuar (procesverbal 002305)se në hapësirën e klasëve, koridoreve dhe nyjeve sanitare kushtet tekniko-higjeno-sanitare janë në nivel.

33. SH.F.M. U“ Abedin Bujupi Arllat“

Gjatë inspektimit të bërë me datë 08.09.2017 është konstatuar (procesverbal 002027)se në hapësirën e klasëve, koridoreve dhe nyjeve sanitare kushtet tekniko-higjeno-sanitare janë në nivel.


34. SH.F.M. U“ Luigj Gurakuqi në Fushticë të poshtme“

Gjatë inspektimit të bërë me datën 11.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002280)se në hapësirën e klasëve, koridoreve dhe nyjeve sanitare kushtet tekniko-higjeno-sanitare janë në nivel, mirëpo në klasën parafillore nuk ka tepih në dysHEME ku nxënësit nuk kanë mundësi t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre.

35. SH.F.M. U“ Ali Gashi në Çikatovë të re“

Gjatë inspektimit të bërë me datën 06.10.2017 është konstatuar (procesverbal 002305)se në hapësirën e klasëve, koridoreve dhe nyjeve sanitare kushtet tekniko-higjeno-sanitare janë në nivelin mesatar, mirëpo jo edhe objekti i parafillorëve i cili është i ndarë nga objekti i shkollës që nga muaji Qershor.

Kushtet Higjeniko-Sanitare në Institucionet Arsimore - Drenas



Aurora Berisha

Drejtoreshë e Drejtorisë së Inspekcionit

Mimoza Berisha

Inspektore Sanitare